



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1195/1 Prot.

Tiranë, më 03.12.2024

VENDIM

Nr. 34, datë 03.12.2024

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. (në vijim “Ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), formularin e ankesës me nr. 1185 prot., datë 03.05.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Bordi i Mbikëqyrjes Publike (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet shkresës datë 12.04.2024, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për Inspektorët e Lartë për Kontrollin e Cilësisë znj/z. Aida Hoxha, Ejmi Plaku dhe Loren Shtyri në lidhje me:

1. Njoftimet lidhur me kërkesën për të punësuar “Inspektor të Lartë për Kontrollin e Cilësisë”.
2. Informacion mbi mënyrën e shpalljes së njoftimit si më sipër:
 - a. Ku është publikuar;
 - b. Data e publikimit;
 - c. Numrin e protokollit.
3. Dokumentacioni i nevojshëm që kandidatët kanë paraqitur si:
 - a. Letër motivimi;
 - b. Dokument identifikimi;
 - c. Curriculum Vitae;
 - d. Fotokopje të noterizuara të diplomave dhe listës së notave;
 - e. Referencë nga punëdhënësi të mëparshëm.

4. *Procesverbalin e shqyrtimit të kërkesave.*
5. *Vendimi mbi kandidatin fitues.*
6. *Njoftimi për kandidatin fitues.*
7. *Informacion mbi mënyrën e shpalljes së kandidatin fitues:*
 - a. *Numrin e protokollit të dokumentacionit.*
 - b. *Mënyrën e publikimit dhe datën e publikimit.*
 - c. *Datën e nisjes së punës së kandidatëve fitues.*
8. *Informacion mbi numrin e gazetës zyrtare ku është publikuar Rregullorja nr. 7, datë 02.10.2018.*
9. *Neni 14/1 "Procesi vjetor i kontrollit të cilësisë" përcakton hapat:*
 - a. *Përcaktimi i inspektorëve;*
 - b. *Përzgjedhja e audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit që do të kontrollohen;*
 - c. *Identifikimi i qëllimit të kontrollit.*

Na vini në dispozicion dokumentacionin lidhur me secilin hap si më sipër.
10. *Në referim të nenit 14/2 "Inspektor të Lartë për Kontrollin e Cilësisë" që janë angazhuar për kontrollin e subjektit tim ende nuk më kanë paraqitur "Planin e punës, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratuar nga Kryetari i BMP". Na vini në dispozicion "Planin e punës, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratuar nga Kryetari i BMP".*
11. *Procesverbalin audio të mbajtur në datën 04.12.2023 në banesën time.*
12. *Procesverbalin e traskiptuar të datës 04.12.2023.*
13. *Në datën 09.04.2024, në takimin përmbyllës u konstatua se znj. Ejmi Plaku ishte zëvendësuar nga znj.Erjola Vejzati.*

Na vini në dispozicion vendimin për ndryshimin e trupës kontrolluese.
14. *Bazën ligjore mbi të cilën është bërë përjashtimi i znj. Ejmi Plaku nga grupi i punës.*
15. *Bazën ligjore të pjesmarrjes në grupin e punës të Drejtoreshës Ekzekutive znj.Erjola Vejzati.*
16. *Në datën 09.04.2024 Drejtoresha Erjola Vejzati ndërpreu protokollimin e takimit. Ju lutem na informoni mbi bazën ligjore të ndërprerjes së protokollimit të takimit.*
17. *Me ndërprerjen e njëanshme të takimit të datës 09.04.2024 nga znj.Erjola Vejzati, pa u arritur qëllimi i takimit. Na informoni datën për vazhdimin e takimit përmbyllës.*
18. *Kontrollin e keni bërë mbi bazën e Vendimit nr. 17, datë 19.03.2021. Në referim të Kodit të Procedurës Administrative neneve 49 dhe 102, sipas bagazhit tim juridik konstatoj se investigimi i subjektit tim mbështetur në Vendimin nr. 17, datë 19.03.2021 është braktisur. Ju lutem na informoni mbi bazën ligjore si dhe dokumentacionin mbështetës, që e bënë vendimin nr. 17, datë 19.03.2021 jo të braktisur.*
19. *Në shkresën nr. 181, datë 19.08.2021 na bëni me dije se kontrolli do të bëhej në periudhën Tetor - Dhjetor 2021. Ju lutem na informoni se pse nuk u bë ky kontroll.*
20. *Në shkresën nr. 181, datë 19.03.2021 konstatojmë se objekti i kontrollit është i ndryshëm nga objekti i prezantuar nga ana juaj në e-mail-in e datës 27.10.2023. Na informoni mbi bazën ligjore ku jeni mbështetur mbi ndryshimet e objektit të kontrollit.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 101 Prot., datë 29.04.2024, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion duke sqaruar se: *“...në zbatim të kërkesave të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe ligjit për të drejtën e informimit të cilit ju i referoheni, ju bëjmë me dije se informacioni i kërkuar nuk është subjekt i këtij ligji. Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP) zbaton dhe vepron në përputhje me programin e transparencës, një program institucional i transparencës, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike, të cilat ju mund t’i aksesoni lehtësisht në faqen zyrtare të institucionit nëpërmjet linkut [https://bmp.al/transparencja/...](https://bmp.al/transparencja/)”*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, me ankesën e cituar si më sipër, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga Autoriteti Publik.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 1183/1 prot., datë 21.05.2024, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimet e ngritur në ankesën objekt shqyrtimi.

Në vijim, Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës me nr. 127 prot., datë 24.05.2024, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1183/2 prot., datë 28.05.2024, duke parashtruar se: *“...informacioni i kërkuar prej palës së kontrolluar/subjekti ankimes, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, është pjesë e procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë dhe në vlerësimin tonë cenon mbarëvajtjen e procedurave të procesit të inspektimit. Gjithashtu, po në mbështetje të ligjit të sipërcituar dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, një pjesë e informacionit cenon të dhënat personale, si dhe sekretin profesional të garantuar nga ligji.*

Për më shumë, bazuar në shkresën e BMP me nr. 101 Prot., datë 29.04.2024, pranë audituesit ligjor/subjektit ankimes është duke u realizuar procesi i kontrollit të sigurimit të cilësisë. Në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 17 të rregullores nr. 7/2018 e kontrollit të cilësisë, e ndryshuar, është koordinuar mes palëve takimi i datës 09.04.2024 me objekt diskutimin e draft raportit të kontrollit të cilësisë. Gjatë këtij takimi, palës së kontrolluar/subjektit ankimes i është sqaruar se në zbatim të shkronjës “d” të nenit 17 të rregullores nr. 7/2018 të kontrollit të cilësisë, e ndryshuar, takimi me diskutimet e realizuara mund të dokumentohen në formë të regjistruar në pajisjen e regjistrimit të BMP, si një e drejtë e palës, me miratimin e shkruar nga audituesi ligjor, subjekt kontrolli, për qëllime të kontrollit të brendshëm të cilësisë. Pala e kontrolluar/subjekti ankimes

nuk ka dakordësuar lidhur me regjistrimin e takimit dhe për këtë arsye kontrolluesi ka vijuar me mbajtjen në formë të shkruar të minutave të takimit, minuta të cilat janë ndërprerë nga kontrolluesi, pasi pala e kontrolluar/subjekti ankimues nuk ka pranuar të diskutojë lidhur me draft-raportin e kontrollit për sigurimin e cilësisë së audituesit ligjor, por ka vijuar me diskutime jashtë objektivit të këtij takimi. Për këtë arsye, kontrolluesi ka ndërprerë takimin dhe ka bërë me dije palën e kontrolluar/subjektin ankimues mbi të drejtën e tij për të ndjekur të gjitha hallkat e ankimit administrativ ndaj procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, të publikuar në faqen e BMP në seksionin e legjislacionit si edhe në seksionin përkatës të programit të transparencës. Pavarësisht dhe sa më sipër, vlerësojmë se dhënia e informacionit kërkuar në datën 12.04.2024, kufizohet nga shkronja “ç” e pikës 2 dhe pika 3 e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar...

Lidhur me kërkesën e palës së kontrolluar/subjektit ankimues të datës 12.04.2024, sikurse është parashtruar edhe më lart, pala e kontrolluar/subjekti ankimues nuk ka qenë bashkëpunues dhe ka ballafaquar strukturën mbështetëse të BMP me pretendimet se nuk ka qenë i sigurt nëse këto zyra i takojnë BMP dhe se punonjësit, prezent në takim, janë pjesë e strukturës mbështetëse duke shprehur dyshime mbi identitetin e tyre, duke cenuar kështu integritetin e institucionit dhe punonjësve. Megjithatë, në vijim të këtyre pretendimeve, punonjësit e strukturës mbështetëse kanë sqaruar të gjithë kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave të autoritetit publik si edhe të drejtën e palës për të ndjekur të gjitha hallkat e ankimit administrativ ndaj procesit të kontrollit të sigurimit të cilësisë. Lidhur me këtë kërkesë, vlerësojmë se dhënia e informacionit të kërkuar kufizohet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, pasi përmban të dhëna që janë pjesë e procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë dhe që cenojnë mbarëvajtjen e procedurave të procesit të inspektimit, si edhe të dhëna që shkelin sekretin profesional.

Dëshirojmë të theksojmë se palës së kontrolluar/subjekti ankimues do t'i vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës që lidhet me procedurat e kontrollit të sigurimit të cilësisë, në zbatim të kërkesave të legjislacionit përkatës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përfundim të këtij procesi...”

Në këto kushte, në ndjekje të procedurave për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nëpërmjet shkresës nr.1183/4 prot., datë 11.10.2024, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seancë kjo e cila me dakordësinë e palëve u zhvillua në datën 07.11.2024 me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesën e paraqitur. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në shkresën nr. 127 prot., datë 24.05.2024, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1183/2 prot., datë 28.05.2024,

shkresë kjo e cila u vendos në dispozicion edhe të ankuesit, si subjekt i interesuar për këtë procedurë, pasi rezultoi se nuk kishte marrë dijeni më parë.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik, për ankesën objekt shqyrtimi, nuk janë plotësisht në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik në mënyrë të përmbledhur ka kthyer një përgjigje nëpërmjet shkresës me nr. 127 prot., datë 24.05.2024, për të gjitha kërkesat për informacion të depozituara nga ankuesi, por, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë për secilën nga pikat e kërkuara, në kundërshtim kjo me LDI, si dhe shkresën nr. 1183/1 Prot., datë 21.05.2024 të Zyrës së Komisionerit, ku ndër të tjera është kërkuar: *“...qëndrimi në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar për secilën nga pikat e kërkesës...”*

Megjithatë, duke analizuar përgjigjen që ka kthyer Autoriteti Publik me nr. 127 prot., datë 24.05.2024, Komisioneri konstaton se ky i fundit ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentet se: *“...informacioni i kërkuar prej palës së kontrolluar/subjekti ankimes, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, është pjesë e procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë dhe në vlerësimin tonë cenon mbarëvajtjen e procedurave të procesit të inspektimit. Gjithashtu, po në mbështetje të ligjit të sipërcituar dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, një pjesë e informacionit cenon të dhënat personale, si dhe sekretin profesional të garantuar nga ligji...*

Pavarësisht dhe sa më sipër, vlerësojmë se dhënia e informacionit kërkuar në datën 12.04.2024, kufizohet nga shkronja “ç” e pikës 2 dhe pika 3 e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar...

Lidhur me këtë kërkesë, vlerësojmë se dhënia e informacionit të kërkuar kufizohet nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, pasi përmban të dhëna që janë pjesë e procesit të kontrollit për sigurimin e cilësisë dhe që cenojnë mbarëvajtjen e procedurave të procesit të inspektimit, si edhe të dhëna që shkelin sekretin profesional.”

Në analizë të këtyre argumentave, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar në pikat 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të kërkesës objekt shqyrtimi, pavarësisht se në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, në rastin konkret, kufizohet në përputhje me shkronjën “ç” të pikës 2 të nenit 17, të këtij ligji, në të cilin parashikohet se: *“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: ...“ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike”.*

Në këto kushte, argumentat e parashtruara nga Autoriteti Publik për këto pika të kërkesës për informacion konsiderohen të bazuara ligjërisht. Rrjedhimisht, duke qenë se Autoriteti Publik rikonfirmoi edhe gjatë seancës dëgjimore që është ende në proces të kontrollit për

sigurimin e cilësisë, Komisioneri vlerëson se kërkimi lidhur me pikat 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të kërkesës objekt shqyrtimi, bazuar në dispozitën e sipërcituar duhet rrëzuar.

Ndërkohë, në lidhje me pikat 1, 2 (a, b, c), 3 (c), 4, 5, 6, 7 (a, b, c), 8, 9 (a, b, c) dhe 10 të kërkesës objekt shqyrtimi, Komisioneri vlerëson se argumentat e sipërcituara të Autoritetit Publik nuk mund të qëndrojnë pasi, *së pari*, ky dokumentacion nuk është pjesë e procedurave të kontrollit për sigurimin e cilësisë dhe nuk mund të ndikojë në mbarëvajtjen e tij.

Së dyti, nga shqyrtimi i këtyre kërkesave, rezulton se kemi të bëjmë me procedura rekrutimi, rregullore apo plane të punës që lidhen me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Autoritetit Publik dhe interesi publik për t'i aksesuar ato është i lartë. Disa nga këto dokumenta përfshihen në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë, bazuar kjo, në shkronjat “a”, “b”, “d”, “k” dhe “l” të pikës 1 të nenit 7 të LDI.

Dispozita e sipërcituar përcakton qartë se: *“1. Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;*

b) tekstet e plota:

i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

ii) të ligjeve;

iii) të akteve nënligjore;

iv) të kodeve të sjelljes;

v) të çdo dokumenti politikash;

vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;...

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;...

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik...”

Së treti, lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, Komisioneri thekson se, në shkronjën “b” të pikës 4, të nenit 4 të ligjit nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji nr. 9887/2008), parashikohet se, ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre. Rrjedhimisht, bazuar në këtë dispozitë, pretendimi i Autoritetit Publik nuk rezulton i bazuar ligjërisht.

Megjithatë, në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave duhet të kryhet duke pasur parasysh respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuara në nenin 5 të Ligjit nr. 9887/2008, veçanërisht parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim. Gjithashtu, përhapja e të dhënave personale është një nga format e përpunimit të të dhënave, të parashikuara në pikën 12, të nenit 3 të Ligjit nr.9887/2008 dhe realizimi i saj duhet analizuar nga kontrolluesi, në përputhje edhe me kriteret e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Në analizë të legjislacionit të sipërcituar, dokumentet e tjera, pjesë e dosjes personale të punonjësve të administratës publike (*psh: Letër motivimi; dokument identifikimi, fotokopje të noterizuara të diplomave, listës së notave, referencë nga punëdhënës të mëparshëm etj*), përmbajnë të dhëna personale dhe si të tilla nuk mund të publikohen/vendosen në dispozicion pa pëlqimin paraprak të subjektit të të dhënave. Ky përcaktim rregullohet edhe nga neni 17/1/a i LDI.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se informacioni lidhur me shkronjat “a”, “b” “d” dhe “e” të pikës 3 të kërkesës objekt shqyrtimi kufizohet. Në këto kushte, ky kërkim duhet rrëzuar.

Ndërkohë, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni në pikat 1, 2 (a, b, c), 3 (c), 4 , 5, 6, 7 (a, b, c), 8, 9 (a, b, c) dhe 10 të kërkesës objekt shqyrtimi, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar, sipas të cilës: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Bordi i Mbikëqyrjes Publike është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së z. _____, me nr. 1185 prot., datë 03.05.2024, ndaj Autoritetit Publik, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikave 1, 2 (a, b, c), 3 (c), 4 , 5, 6, 7 (a, b, c), 8, 9 (a, b, c) dhe 10 të kërkesës për informacion datë 12.04.2024, duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 11.12.2024.
3. Rrëzimin e ankesës për shkronjat “a”, “b”, “d” dhe “e” të pikës 3, si dhe pikat 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20 të kërkesës për informacion datë 12.04.2024.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 03.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi